



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 18.3.2023

Nr: 177

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KOALICIONIT “ALEANCA LIBERALE E DJATHTË”,
(ALD), PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë, 18.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1693 Prot., datë 15.3.2023, me:

Kërkues: Partia “Balli Kombëtar Demokrat”, Partia “Bashkimi Liberal Demokrat”, Partia “Bashkimi Demokrat Shqiptar”

Objekti: Regjistrimi i koalicionit “Aleanca Liberale e Djathtë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Baza ligjore: Neni 65 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Koalicioni Zgjedhor “Aleanca Liberale e Djathtë”, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023.

Data: 18.3.2023 Nr: 177
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Aleanca Liberale e Djathtë”, (ALD), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Bazuar në nenin 65 të Kodit Zgjedhor, pranë KQZ– së janë regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore partitë politike si më poshtë vijon:

1. Partia “Balli Kombëtar Demokrat” me kryetar z. Artur Roshi, miratuar me vendimin, nr.125, datë 8.3.2023;
2. Partia “Bashkimi Liberal Demokrat” me kryetar z. Arian Starova, miratuar me vendimin, nr.137, datë 8.3.2023;
3. Partia “Bashkimi Demokrat Shqiptar” me kryetar z. Ylber Valteri, miratuar me vendimin, nr.107, datë 8.3.2023;

Me shkresën nr. 1693 prot., datë 15.3.2023, në zyrën e protokollit të KQZ-së, partitë e sipërpërmendura, nëpërmjet kërkesës së bërë nga partia përfaqësuese partia “Balli Kombëtar Demokrat” kërkojnë regjistrimin e koalicionit “Aleanca Liberale e Djathtë” (PBKD – BLD – PBD) si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Bashkëlidhur kërkesës për regjistrimin e koalicionit Aleanca Liberale e Djathtë (PBKD – BLD – PBD), është depozituar edhe marrëveshja për krijimin e koalicionit, në të cilën është shprehur vullneti i partive të sipërpërmendura për të qenë pjesëmarrëse të këtij koalicioni.

Marrëveshja përmban:

1. Shprehjen e vullnetit të partive pjesëmarrëse për të qenë pjesëtare të koalicionit;
2. Formimin e koalicionit me emrin “Aleanca Liberale e Djathtë” (PBKD – BLD – PBD);
3. Shkronjat nistore të koalicionit “ALD”;
4. Siglën e koalicionit;
5. Autorizimin e z. Artur Roshi, kryetar i Partisë “Balli Kombëtar Demokrat”, të dorëzojë listat shumëmbrore dhe çdo dokumentacion të nevojshëm për regjistrimin e koalicionit.
6. Fushata e koalicionit “Aleanca Liberale e Djathtë” do të drejtohet nga partia “Balli Kombëtar Demokrat”;
7. Përfaqësuesi i koalicionit për marrëdhëniet me KQZ- në do të jetë z. Ylber Valteri;
8. Personi që do të përfaqësojë koalicionin në KQZ do të jetë z. Shaqir Rexhvelaj;
9. Numri i kandidatëve dhe renditja e tyre do të bëhet sipas marrëveshjes midis palëve në një moment të dytë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bëri verifikimet përkatëse dhe konstatoi se, dokumentacioni i paraqitur nga 3 partitë e sipërcituara është në përputhje me nenet 65 e 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenet 64, 65 e 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Regjistrimin e Koalicionit “Aleanca Liberale e Djathtë” (PBKD – BLD – PBD), “ALD”, si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, me parti pjesëtare të tij si më poshtë:
 - a. Partia “Balli Kombëtar Demokrat” (PBKD);
 - b. Partia “Bashkimi Liberal Demokrat” (BLD);
 - c. Partia “Bashkimi Demokrat Shqiptar” (PBD);
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI